


Zhvillohet nga IDI takimi vjetor LOTA Talks 2024

Më datë 12.12.2024, u zhvillua event i vjetor *online* LOTA Talks 2024, i organizuar nga INTOSAI Development Initiative (IDI) me tematikë “Zgjidhjet për Monitorimin e Vazhdueshëm”, i cili konsistoi në 4 sesione kryesore të zhvilluara përgjatë 2 orëve.

LOTA Talks përfaqësojnë evente të organizuara çdo vit nga ekspertë dhe vizionarë të fushës, nga sektori publik dhe privat në kuadër të zhvillimeve më të fundit, për të orientuar audituesit drejt shkëmbimit të eksperiencave dhe praktikave më të mira.



Tematika e këtij viti e lidhur me monitorimin e vazhdueshëm, i orientoi diskutimet drejt prezantimit të qasjeve praktike për të adresuar dobësitë në qeverisjen lokale, zbulimit sesi automatizimi revolucionarizon auditimin financiar dhe mundëson monitorimin në kohë reale, të mësuarit mbi implementimin e platformave analitike për transparencë të shtuar dhe efikasitet në auditim, si dhe të kuptuarit e qasjeve të orientuara drejt të dhënave për të identifikuar risqet dhe përmirësuar praktikën qeveritare. Përkatesisht, diskutimet konsistuan në prezantimet e mëposhtme:

1. Auditimi i vijueshëm i procedurave lokale të cënueshme nga korrupsioni – prezantuar nga Rocío Alfaro Vargas, SAI i Kostës Rikë;
2. Rrjedha e të dhënave të automatizuara dhe përpunimi i tyre për auditimin financiar – prezantuar nga Alvar Nouakas dhe Hanna-Marleen Penno, SAI i Estonisë dhe shefi i sekretariatit të EUROSAT ITWG;
3. Krijimi i një platforme analitike në CDMA për monitorimin e vazhdueshëm – prezantuar nga Raj Kamal Ranjan, SAI i Indisë;
4. Sistemi i vlerësimit të riskut qeverisës: analizimi i avancuar i të dhënave për të frenuar korrupsionin – prezantuar nga Daniel Ortega Nieto, Banka Botërore.

Duke qenë se monitorimi i vijueshëm është thelbësor për të mundur mirëfunksionimin e sistemeve, nga pjesëmarrësit u theksua nevoja për orientimin drejt praktikave më të mira dhe ndarjes së eksperiencave, me qëllim rritjen e njohurive nga eksperiencat më të mira ndërkombëtare duke vijuar me serinë e këtyre diskutimeve edhe në të ardhmen.